

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**, Departamenti i Pergjithshem  
 Divizioni Civil, Gjyqtari Skender Shala, ne qeshtjen juridike te paditesit  
 nga Mitrovica, te cilin sipas autorizimit me shkrim e perfaqson Av.  
 nga Mitrovica, kunder te paditues Komuna e Mitrovice, te cilen e perfaqeson  
 Avokati Publik Komunal per vertetim pronsie, vlera e kontestit  
 1.250,00 Euro, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor dhe publik te dt. 07.05.2018, me dt.  
 22.05.2018. bie kete:

## AKT GJYKIM

**I. VERTETOHET** se paditesi nga Mitrovica eshte pronar i  
 objektit afarist - lokalit te karakterit te perkohshem ne siperfaqe te gabariteve prej  
 S=36 m2 (P+1) dhe i njihet e drejta e shfrytzimit te paluajtshmerise - pjeses se  
 ngastres katastrale nr. , ne siperfaqe prej S=18 m2, ne te cilen eshte ndertuar  
 objekti afarist - lokali i karakterit te perkohshem, per perdorim dhe shfrytezim te  
 rregullt te objektit afarist - lokalit, gjithnje per kohen e ekzistimit te objektit afarist -  
 lokalit e ne perputhje me karakterin ndertimor te tij, me kulture jo pjellore, ne vendin  
 e quajtur "Rr. " me masat dhe kufijte qe jane shenuar ne skicen e  
 terenit te ekspertizes dhe pronar i objektit afarist - lokalit te karakterit te perkohshem  
 ne siperfaqe te gabariteve prej S=44 m2 (P+1) dhe i njihet e drejta e shfrytzimit te  
 paluajtshmerise - pjeses se ngastres katastrale nr. , ne siperfaqe prej  
 S=20m2, ne te cilen eshte ndertuar objekti afarist - lokali i karakterit te perkohshem,  
 per perdorim dhe shfrytezim te rregullt te objektit afarist - lokalit, gjithnje per kohen  
 e ekzistimit te objektit afarist - lokalit e ne perputhje me karakterin ndertimor te tij,  
 me kulture jo pjellore, ne vendin e quajtur " " me masat dhe  
 kufijte qe jane shenuar ne skicen e terenit te ekspertizes, e tere kjo evidentohet ne  
 emer te te paditues P.SH.

**II. OBLIGOHET** e paditura qe t'ia njohet kete te drejte paditesit dhe t'i  
 lejoje paditesit rexhistrimin e kesaj te drejte te Zyra Kadastrale Komunale ne  
 Mitrovice, ne afatin prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimit te ketij  
 aktgjykimi, nen kercenim te permbarimit.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore.

## Arsyetim

Paditesi ne padin e tij te parashtruar e permes te autorizuarit te tij ka theksuar  
 se njesia kadastrale P - - ZK Mitrovice, ne siperfaqe te  
 teresishme prej 821 m2, sipas certifikates se pronesise ne librat  
 kadastrale te cilut udheheqen per Komunenn e Mitrovice evidencohen ne emer te te  
 paditues si prone shogerore te Kuvendit Komunal ne Mitrovice. Organi kompetent I  
 KK Mitrovice te asaj kohe, ne baza te vendimit nr. 04-361/37 te dt. 20.02.1976

paditesit i ka dhene ne shfrytezim pjesen e kesaj paluajteshmerie ne siperfaqe prej 19 m2 , me deshtimin per ndertimin e dyqanit per ushtrimin e veprimtarise se rrobaqepesit, dhe menjeter pas marrjes ne shfrytezim te kesaj paluajteshmerie, paditesi ne ate vend me njetet e veta financiare e ka ndertuar dyqanin dhe ne te ka ushtruar veprimtarin e rrobaqepesit qe nga ajo kohe e deri me sot, ndersa qe njeiti lokal ka qene indentifikuar si lokali afarist me numer 5 dhe poashtu me date 08.06.1994 paditesi po ne kete paluajteshmeri ne baze te kontrates me shkrim mbi shitblerjen e lokalit afarist te lidhur me zotiri ish, nga Mitrovica e ka blere edhe lokalin afarist nr.1 ne siperfaqe prej 19 m2 dhe se lokalet 1 ka shfrytezuar deri ne vitin 1999 ku gjate luftes ne Kosove te njejtat jane djegur, me c'rast paditesit iu eshte djegur i tere inventari dhe shume dokumente tjera e nder to edhe vendimi me te cilin nga organi kompetent i atehershem i te paditures iu eshte dhene ne shfrytezim lokali afarist me nr. 5. Pas perfundimit te luftes ne Kosove, paditesi me njetet e veta financiare menjehere ne kete paluajteshmeri po ne te njeitin vend i ka ndertuar dy lokale te reja me nga dy kate secila ne siperfaqe prej 40 m2 , dhe te njejtat qe nga ajo kohe i shfrytezon per ushtrimin e veprimtarise rrobaqepesit pa u penguar asnjeher nga askush. Ne seancen e shqyrtimit gjyqesor i njeiti ka deklaruar se mbetem ne teresi prane padise dhe kerekspadise se parashtruar, te plotesuar dhe permiresuar si ne seancen e kaluar dhe deklarimeve si ne seancat e kaluara dhe duke marre parasysh faktin se me kohe nga ana e gjykates e kam pranuar ekspertizen e punuar nga eksperti gjeodet se bashku me dokumentacionin tjetër relevant per te cilin ekspertize konsideroj se eshte e plote dhe permban te dhenat e nevojshme ne lidhje me siperfaqen shtrirjen , permasat dhe perkufizimin e lokaleve afariste tani lendore, ashtu qe tani e beje precizimin e kerkespadise se paditesit ne pajtim me ekspertizen ne fjale duke theksuar se paditesi sipas konstatimit te ekspertit gjeodet ne teren i mbane 2 lokale afariste dhe ate lokalin afarist te emertuar ne ekspertize si lokali afarist nr. 1 me etazhitet P + 1 ne siperfaqe te njejte si ne pjesen perdhese ashtu edhe ne katin e pare prej S=18 m2 dhe lokalin afarist te emertuar ne ekspertize si lokali afarist nr. 2 me etazhitet P+ 1 ne perdhese ne siperfaqe prej 20 m2 , ndersa ne katin e pare se bashku me konzolle ne siperfaqe prej 24 m2 qe ted y lokalet te ndertuara me material te forte ndertimor. Gjykates i propozoj qe te vazhdoi me procedimin e metejme te kesaj ceshtjeje lendore dhe ta beje administrimin e provave te propozuara si ne padi dhe poashtu ne cilesi te pales ta degjoi paditesin lidhur me kete ceshtje lendore e sidomos ne lidhje me menyren e mbajtjes gjegjesisht posedimit te lokaleve ne fjale , ndertimit dhe rindertimit te tyre pas djegjeve dhe shkaterrimit te vitit 1999 dhe ceshtjet tjera per te cilin gjykata gjene se jane ne interes ne kete ceshtje. Ne fjalen e tij perfundimtare ka theksuar se mbetem ne teresi prane padise dhe kerkespadise se parashtruar, te plotesuar dhe te precizuar si ne seancen e shqyrtimit kryesor te kesaj ceshtje, pra mbetem ne teresi prane propozimeve dhe thenjeve si ne seancat e kaluara te mbajtura ne lidhje me kete ceshtje tani lendore , dhe konsideroj se nga provat e administruara u vertetua baza juridike e kerkespadise se paditesit gjegjesisht fakti se paditesi pronesin ne lokalin afarist te emertuar ne ekspertizen gjeodet si lokali afarist nr.1 me etazhitet P+1, ne siperfaqe prej S=18 m2, si ne pjesen perdhese ashtu edhe ne katin e pare, dhe pronesin ne token ku eshte ndertuar ky lokal afarist, e ka fituar nga baza juridike, dhe ate duke marre parasysh bazen juridike gjegjesisht ligjin ne fuqi kur eshte krijuar baza juridike e kerkespadise se paditesit; sipas Veprimit juridik gjegjesisht ne baze te kontrates mbi shitblerjen e lokalit afarist te dates 08.06.1994, te blere nga zoteriu ( konvalidimi i kontrates sipas nenit 73 te LMD ) ne baze te Aktvendimit te organit kompetent te te paditures te asaj kohe, mbi bartjen e te drejtes se shfrytezimit te tokes ndertimore ku ka qene i ndertuar lokali afarist i blere sipas kesaj kontrate, nga shitesi

tek bleresi . I 1 dates 19.09.1996, na baze te ndertimit dhe investimit te bere ne te njejtin pas djegjes se ketij lokali ne vitin 1999, (pra sipas vete ligjit, ne pajtim me nenin 20 par.1 lidhur me nenin 22 par.1 dhe 2 te LMTHPJ, me krijimin e sendit te ri ) si mbajtes I ligjshem dhe me mirebesim per me teper se 10 vite, gjegjesisht si mbajtes me mirebesim per me teper se 20 vite , sipas nenit 28 par.2 gjegjesisht neni 28 par.4 I LMTHPJ, ndersa sipas ligjit ne fuqi kur e ka parashtruar padine ne gjykate per vertetimin e pronesis, si mbajtes me mirebesim per me shume se 20 vite, ( ne pajtim me dispoziten e nenit 40 par.1 te LPDTS ) e cila palujtshmeri gjegjesisht toke evidentohet ne emer te te paditures Komuna e Mitrovices, si ngaster kadastrale me numer . ZK Mitrovice, sipas Certifikates se pronesis me numer te lendes , ZK Mitrovice ne vendin e quajatur " . Sa I paket fitimit te pronesis ne lokalim afariste te emertuar ne ekspertize si lokali afariste numer 2, me etazhitet P+1 ne perdhes ne siperfaqe prej S=20 m2 ndersa ne katin e pare se bashku me konzoll ne siperfaqe prej 24m2 dhe pronesise ne token ku eshte I ndertuar ky lokal afariste, paditesi pronesine ne kete lokal afrist dhe token ne te cilin eshte I ndertuar ky lokal afarist poashtu e ka fituar nga disa baza juridike , dhe ate duke marre parasysh ligjin ne fuqi kur eshte krijuar baza juridike e kerkespadise dhe paditesit , ne baze te vendimit te organit shtetrorre gjegjesisht aktvendimit te organit kompetent te te paditures, per vendosjen e lokalit afarist, Ne numer te dates 20.02.1976 ne baze te aktvendimit mbi vazhdimin e vlefshmerise se ketij vendimi, 08 Nr te dates 27.03.1997, ne baze te veprimit juridik gjegjesisht kontrates respektive per dhenjen ne shfrytezim te kesaj paluajtshmerie, te cilat per fat te keqe tani paditesi nuk I posedon sepse te njejta I jane djegur gjate luftes se vitit 1999 me shume dokumenta te tjera, kur iu eshte djegur edhe lokali afarist tani lendor dhe se keto kontrata me te cilat iu eshte vazhduar e drejta e shfrytezimit te paluajtshmerise lendore kane qene qe nga viti 1976 e deri ne vitin 1997, pra deri ne kohen kur gjendja politike dhe e sigurise ne Mitrovice dhe gjithandej neper Kosove ka qene e rende dhe ne prag te luftes se vitit 1999 (sipas vete ligjit, neni 20 par. 1 dhe 2 te LMTHPJ-se ) ne baze te ndertimit dhe investimit te bere ne te njejtin lokal afarist pas djegjes se tije ne vitin 1999, (ne pajtim me nenin 20 par. 1 lidhur me nenin 22 par. 1 dhe 2 te LMTHPJ-se – me krijimin e sendit te ri) dhe si mbajtes I ligjshem dhe me mirebesim per me teper se 10 vite, gjegjesisht si mbajtes me mirebesim per me teper se 20 vite, sipas nenit 28 par.2 gjegjesisht nenit 28 par.4 I LMTHPJ-se. Ndersa sipas ligjit ne fuqi kur e ka parashtruar padine ne gjykate per vertetimin e pronesise si mbajtes me mirebesim per me shum se 20 vite , ne pajtim me dispozitat e nenit 40 par. 1 te LPDTS. Nese eventualisht gjykata ne baze te provave te adminsitruara dhe vleresimit te tyre, nuk e aprovon si te bazuar kerkespadine e paditesit dhe te njejtin nuk ia njeh te drejten e pronesise ne lokalet afariste tani lendore dhe token se ku jane te ndertuara keto locale afariste, paditesi e parashtron edhe kerkesen alternative, qe gjykata mbi bazen juridike te cekur si me larte te njejtin te ia njoh te drejten e pronesise ne keto dy locale afariste tani lendore dhe te drejten e shfrytezimit te paluajtshmerise gjegjesisht tokes ne te cilin jane te ndertuara keto dy lokale afariste e cila toke sherben per perdorim dhe shfrytezim sa me te mire dhe te rregullte te tyre e cila paluajtshmeri gjegjesisht toke evidentohet ne emer te te paditures Komuna e Mitrovices, si ngaster kadastrale me nr. ZK Mitrovice, sipas cartifikates se pronesise me nr. te lendes ZK Mitrovice ne vendin e quajtur "

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoi.

Perfaqesuesi i te paditures ne pergjigje te padise dhe kerkespadise ka theksuar se: e kundershtoj padine dhe kerkespadine e pales paditese duke e vu theksin ne dy ceshtje e para eshte te vendimi I dt. 20.02.1976 qe ky vendim ne emer te kujte eshte leshuar te organit kompetent dhe e dyta ceshtja e kontrates te shitblerjes me dt. 08.06.1994 qe pretendohet kontrat mbi shitblerjen nga z. . dhe nese karakteri I ketyre vendimeve ka qene I perkohshem a ka pas te drejte ta shes ate lokal, dhe keto lokale a kane qene montazh apo kane qene ndertim I materialit te forte ndertimor. Deri ne vitin 1999 ku jane djegur keto lokale me cfar materiale kane qene te ndertuara. Pas vitit 1999 objektet e ndertuara a kane pas leje per ndertim nga Komuna e Mitrovices, apo vitet ne vijim a ka pasur tentative per ndonje marreveshje ne mes te paditesit dhe organeve komunale te Komunes se Mitrovices. Nuk e kundershtoj propozimin e te autorizuarit te paditesit per daljen e gjykates ne vend se bashku me ekspertin gjeodet si dhe nxjerrjen e provave tjera te nevojshme. Ne seancen e shqyrtimit kryesor dhe ne fjalen e tij perfundimtare ka theksuar se fillimisht e kundershtoj padine dhe kerkes padin e pales paditese mirepo gjat seancave te mbajtura si dhe me prezencen time ne vend shiqim te lolakeve nr 1 dhe 2 se bashku me ekspertin gjeodet . qe I ka bere edhe ekspertizen u qartesian historiku I ketyre dy lolakave qe datojne lokali nr 1 I vititi 1994 ku eshte bere kontrata e shitblerjes ndersa , loklai nr 2 prej vitit 1976 keto dy momente si dhe ekspertiza ekspertit gjeodet poashtu edhe degjimi I sotshem I paditesit ne ciles te pales na e qarteson defintivisht situaten e lirdhur ne kete ceshte ku kontesti juridik ndodh pas vitit 1999 dhe lidhur me kete ceshtje I kerkoj gjykates qe te sjell vendim meritore duke u bazuar ne provat te cilata I posedon si shkresat e lendes.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk I kerkoi .

Gjykata me qellim te vertetimit te drejte dhe te plote te gjendjes se fakteve per aq sa palet ndergjyggjese i parashtruan ato dhe propozuan prova per provimin e tyre , ne kuptim te nenit 7 te LPK-se, ne proceduren e provave ne shqyrtimin kryesor te mbajtur me dt. 07.05.2018, beri administrimin e provave me leximin e: procesverbalit mbi vendeshiqimin te kesaj gjykate C.nr.201/2015 i dt. 02.03.2018, certifikatat mbi pronesine me nr. te lendes . te dt. 14.03.2018, ZK Mitrovice, ne emer te te paditures, ekspertizen se ekspertit gjeodet . te dt.13.03.2018, aktvendimin nr. 054-361/37 te dt.20.02.1976, leshuar nga Kuvendi I Komunes se Mitrovices – Sekretariati per ekonomi dhe pune komunale, aktvendimin 08. Nr. 201-1/39 te dt. 25.03.1983, leshuar nga Sekretariati per Pune Brendshme KK Mitrovice – Drejtorati per ceshtje administrative-juridike e te perbashketa, kontraten mbi shitblerjen e lokalit afarist te dt. 08.06.1994 e lidhur ne mes paditesit Faruk Gerxhaliu si bleses dhe . si shites, kontraten per kompenzimin e shpenzimit lidhur me rregullimin e tokes ndertimore nr. 01-112 e dt. 28.07.1994 e leshuar nga Fondi dhe rregullimin dhe administrimin e tokes ndertimore, vendimin nr. 03-356-61 I dt. 19.09.1996 leshuar nga Sektori per financim zyra per pune juridiko-pronesore KK Mitrovice, kontraten per kompenzimin e shpenzimeve per rregullimin e tokes ndertimore nr. 01-105 te dt. 25.12.1996, leshuar nga Drejtoria per token ndertimore dhe rruget, faurat e tatimit ne prone, te rrymes dhe te mbeturinave ne emer te paditesit, beri veshtrim ne skicen e terenit dhe kopien e planit nga eksperti gjeodet ne skicen e kioskut – montazh e karakterit te perkohshem me



Nga vendimi nr. 03-356-61 I dt. 19.09.1996 leshuar nga Sektori per financim zyra per pune juridiko-pronesore KK Mitrovice, vertetohet se paditesit nga ana e te paditures I lejohet bartja e te drejtes se shfrytezimit te perkohshem ne token ndertimore te qytetit nga shfrytezuesi I mehershem ne shfrytezuesin e tanishesit. ne ngastren kadastrale nr. 1571 ne siperfaqe prej 19 m2 ne dimensione prej 4.00 x 5.00 m.

Nga kontrata per kompenzimin e shpenzimit lidhur me rregullimin e tokes ndertimore nr. 01-112 e dt. 28.07.1994 e leshuar nga Fondi dhe rregullimin dhe administrimin e tokes ndertimore, vertetohet se paditesi me te padituren ka lidh kontrate per kompenzimin e shpenzimeve per rregullimin e tokes ndertimore.

Nga kontrata per kompenzimin e shpenzimeve per rregullimin e tokes ndertimore nr. 01-105 te dt. 25.12.1996, leshuar nga Drejtoria per token ndertimore dhe rruget, vertetohet se paditesi me te padituren ka lidh kontrate per kompenzimin e shpenzimeve per rregullimin e tokes ndertimore.

Nga faturat e tatimit ne prone, te rrymes dhe te mbeturinave ne emer te paditesit, vertetohet fakti se paditesi eshte ngarkuar me shpenzimet e rrymes, ujit dhe tatimit ne prone.

Nga skica e kioskut - montazh e karakterit te perkohshem me dimensione 5.00 x 3.00 m vertetohet lokacioni, shtrirja dhe perkufizimi dhe siperfaqja e kioskes montazhe te karakterit te perkoheshem.

Nga skica e terenit te dt. 13.10.2016, shifet shtrirja, vendi, perkufizimi dhe siperfaqja e paluajtshmerise tani lendore.

Nga kopia e planit e leshuar nga Drejtoria Gjeodete Komunale ne Mitrovice shifet shtrirja si dhe perkufizimi I paluajtshmerise tani lendore.

Nga protokoli i rregullimit nr. te 1996 te cekur me larte vertetohet gjendja faktike ne teren si dhe te shtrirjes dhe pozicionit te objektit lokalit afarist ne palujtshmerine perkatese.

Paditsi ne cilsu te pales ne seancen e shqyrtimit kryesor deklaroi Lokalin I cili ne eksperitizen e ekspertit gjeodet I cili quhet nr. 1 e I cili eshte afer rruges kryesore e kam blere ne vitin 1994 nga shitesi ne siperfaqe prej 19 m2, por kur kam ndertuar kam ikur nga rruga 1 meter qe mos ta pengoj rrugen. Ai lokal ka qene nje katesh dhe ka qene I ndertuar nga dy anet e tij me material te forte ndersa ne te dy anet tjera ka qen prej xhamit I ndertuar nga konstrukcioni metalik qe ka sherbyer per reklam dhe menjeher kam filluar ne te njejtin vit si rrobaqepes ne te njejtin lokal deri ne kohen e luftes ne vitin 1999 kur per shkaqe te njohura na eshte deshte ta leshojme punen dhe te ikim. Kur jam kthyer pas perfundimit te luftes ne vitin 1999 ne muajin Gusht lokalit e kam gjetur te djegur. Ate vit nuk kam mujtur ta rifolloj rindertimin e lokalit sepse nuk kisha mjete port e njejtin ia kam filluar ta rindertoj ne muajin Maj te vitit 2000. Fillimisht e ka rindertuar me dimensione ashtu sic ka qene lokalit I meparshem, pastaj kam filluar te punoj profesionin e rrobaqepsit. Ndersa pas nje kohe diku ne vitin 2008 kam ndertuar edhe katin e dyte mbi ate perdheses ku edhe sot e

7

kesaj dite e ushroj profesionin e rrobaqepsit ne ate lokal - katin e dyte, ndersa katin e pare e kam te leshuar me qira per berber-sallon e meshkujve. Sa I perket lokalet te quajtur ne eksprtizen e ekspertit si lokal nr. 2 I cili gjindet me ne thelesi nga rruga kryesore . Te njejtin e kam ndertuar ne vitin 1976 ne baze te lejes te cilen ma ka dhene komuna. Lokalin e kam ndertuar prej konstrukcionit prej metalin , ndersa baza ka qene prej betoni. Ne ate vend kur une kam filluar ta ndertoj ate lokal, nuk ka pas te ndertuar asgje. Ajo leje e dhene nga komuna me eshte dhene qe te investoj ne lokalin montazh me dimensione 4.00 x 5.00 m. Ne ate kohe nuk ka pas lokale te tjera pervec lokaleve te mia ne ate pjese te qytetit. Ne ate lokal qe nga ai vit 1976 kam filluar te punoj si rrobaqepes deri ne vitin 1994 kur kam kaluar ne lokalin e ashtuquajtur nr. 1 qe te punoj si rrobaqepes. Edhe ky lokal eshte djegur gjate luftes ashtu si lokali nr. 1. Sa I perket lokalit nr. 2 deklaroj se per te njejtin kam kerkuar leje per shfrytezimin e tokes ndertimore per cdo 2 vite deri ne fillimin e luftes. Pas perfundimit te luftes mua nuk me eshte kerkuar nga askush qe te vazhdoj kete leje edhe me tutje . Ndersa I kam paguar te gjitha obligimet si tatimin ne prone, shpenzimet e rrymes, ujit, mbeturinave dhe PTK-se, meqe sic e cekam me larte edhe ky lokal eshte djegur gjate luftes te njejtin e kam rindertuar ne vitin 2004, themeli ashtu sic ka qene me te njejtin dimensione por me material te forte ndertimor por e kam shtuar edhe katin e dyte poashtu me material te fort ndertimor. Me pergjegjesi te plote e theksoj se deri me ditën e sotme askush nga organet komunale te Mitrovices e as ndonje person fizik nuk ka ardhur tek une e te me pengoj ne shfrytezimin e ketyre lokaleve, andaj te tillat I kam poseduar pa u penguar nga askush.

Nga provat e cekura me larte dhe nga nje gjendje e tille faktike te vertetuar gjykata vendosi si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi konform nenit 20 al 1 dhe 12 al 1 te Ligjit mbi Marredheniet Themelore Pronesore Juridike dhe nenit 11 al 1 te Ligjit Mbi Token Ndertimore.

Ne baze te nenit 20 al. 1 te Ligjit mbi Marredheniet Themelore Juridike-Pronesore eshte percaktuar se e drejta e pronesise fitohet sipas vete ligjit, ne baze te veprimit juridik dhe me trashigimi. Ndersa ne alinen 2 te te njejtin nen eshte percaktuar se e drejta e pronesise fitohet edhe **ne baze te vendimit te organit shtetror ne kushtet dhe menyren e percaktuar me ligj.**

Ne baze te nenit 12 al. 1 te Ligjit mbi Marredheniet Themelore Juridike Pronesore eshte percaktuar se kur ndertesa mbi te cilen ekziston e drejta e pronesise eshte ndertuar, na pajtim me ligjin, ne token ne pronesine shoqerore, pronari I ndertesës ka te drejten e shfrytezimit te tokes ne te cilen eshte ngritur ndertesa dhe te tokes qe sherben per perdorimin e rregulte te kesaj ndertese deri sa ajo te ekzistoj.

Pasi qe kemi te bejme me toke ndertimore, Ligji mbi token Ndertimore e percakton dhe parasheh te drejten e shfrytzimit ne token urbane , me konkretisht ne dispoziten e nenit 11 al. 1 te te njejtin ligj eshte percaktuar se e drejta e shfrytezimit ne token ndertimore urbane nenkupton te drejten e shfrytezimit te paluajteshmerise e cila perfshin token nen objektin ndertimor e cila sherben per shfrytezim te rregulte te objektit ne te cilen ekziston e drejta e shfrytezimit perkatesisht e drejta e pronesise, ne kufijte e percaktuar me ligj per kohen e ekzistimit te objektit.

Ne baze te gjendjes te vertetuar faktike dhe provave te administruara si me farte dhe deklarates se dhene nen betim te pales paditse ne cilsu te pales dhe duke iu referuar dispozites se nenit 20 al. 2 te Ligjit mbi Marredheniet Themelore Juridike-Pronesore te lartcekur, gjykata konkludon se paditisi eshte pronar i objekteve afariaste lokaleve te karakterit te perkohshem, ndersa sa i perket njohjes se te drejtes se shfrytzimit te tokes i referohet dispozites se nenit 12 al.1 te Ligjit mbi Marredheniet Themelore Juridike Pronesore dhe nenit 11 al. 1 te Ligjit mbi Token Ndertimore, sipas te cilave kuptohet interpretimi per te drejten e shfrytzimit te tokes ne te cilen eshte ngritur objekti, per kohen e ekzistimit te objektit nga se nga e paditura asnjehere nuk eshte kundershuar mbrenda afatit 10 vjeqar, madje e paditura nuk kerkoj as kompenzimin per te drejten e shfrytzimit te tokes nen objektet afariste – lokaleve ( neni 24 al.2 te LMTHJ) te cekur si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.


Gjykata ne kete rast i aplikoi dispozitat e LMTHJP dhe LTN nga se raporti juridik konkret i qeshtjes kontestimore eshte sajuar ne kohen kur ne aplikim kane qene ligjet e lartecekura.

Vendimin qe secila pale ti barte shpenzimet e veta te procedures kontestimore, gjykata e bazoi konform nenit 459.1 te LPK-se.

Nga permbledhja e fakteve dhe arsytet ligjore te cekura me lart, konform nenit 143.1 te LKK –se, u vendos si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE**  
**C.nr.201/2015, dt.22.05.2018.**

Gjyqtari,  
 Skender Shala



**KESHILLE JURIDIKE:** Kunder ketij aktgjykimi eshte e lejuar anekesa, ne afat prej 15 (pesembedhjet) diteve, nga dita e pranimi, Gjykates se Apelit ne Prishtine, e permes kesaj gjykate.